



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLIKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC

P.nr.1068/2015

Më
Dana

06. 11. 2018

G/11
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM -
 DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale
 kundër, [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga
 [REDAKTUAR] të akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2653-2/14
 të dt 24.08.2015, sipas së cilës në bashkëkryerje kryen veprën penale lëndim të lehtë trupor
 nga neni 188 par.1 nën par.4 KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit
 ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.07.10.2015 solli

AKT GJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2653-2/14 të dt
 24.08.2015 dhe kjo gjykatë jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

1. I akuzuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga [REDAKTUAR], i lindur më datë
 [REDAKTUAR] në të njejtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR]
 shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes
 së varfër ekonomike, me letërnjoftim me numër personal [REDAKTUAR], mbrohet në liri,

2. I akuzuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga [REDAKTUAR], i lindur më datë
 [REDAKTUAR] në Gjilan, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas i
 Republikës së Kosovës, ka kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfër
 ekonomike, me letërnjoftim me numër personal [REDAKTUAR], mbrohet në liri,

JANË FAJTOR

Sepse me datë 02.11.2014 rreth orës 15:45, në Ferizaj, në rrugën "Bostonit" pas një
 zënke të më hershme që kan pasur me të dëmtuarin [REDAKTUAR], të pandehurit në
 bashkëkryerje e kanë sulmuar fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me grushta dhe shkelma
 në pjesë të ndryshme të trupit, me të cilin rast i dëmtuari kishte pësuar lëndime të lehta
 trupore-ndrydhje e indeve të buta në regjionin e kokës, hundës dhe regjionin përreth syrit të
 djathtë e shoqëruar me gjakëderdhje lokale, lëndime këto me pasoja të përkohshme për
 shëndet,-

- me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni
 188 par.1 nën par.4 lidhur me nenin 31 të KPK-së

- Andaj gjykata në bazë të neneve 4; 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve
 365 e 495 të KPPK-së i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

I. Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind
 Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e
 plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

II. Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'u shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'iu llogaritet nga një (1) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizaji, rruga [REDAKTUAR]', për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në procedurë kontesdtimore.

Obligohen të akuzuarit që për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor secili veç e veç të paguajnë nga 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2653-2/14 të dt 24.08.2015 24.08.2015 ka akuzuar [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga [REDAKTUAR]' me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale lëndim të lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.4 KPRK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 188 par.1 nën par.4 të KPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjyqtari ka lëxuar ekspertiza, mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjekoligjor i datës 05.01.2015, deklarata e të pandehurve e datës 04.11.2014, deklarata e të dëmtuarit e datës 03.11.2014 ldhur me lëndimet e të dëmtuarit dhe nga shiqimi i shkresave të kësaj lënde penale ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


Konform nenit 463 par 1 të KPPK-së të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga Ferizaj rruga [REDAKTUAR]', për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguajn shumën prej 20 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në mënyrë solidare në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.1068/2015 i dt.07.10.2015

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.